




**DRAFT-PLANI LOKAL I VEPRIMIT
PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË
KOMUNITETEVE ROM,ASHKALI DHE
EGJIPTIAN
I KOMUNËS SË GJAKOVËS
2024-2026**

Gjakovë, Dhjetor 2023

Komuna e Gjakovës

**Plani lokal i veprimit për avancimi e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian
i Komunës së Gjakovës 2024-2026**

Ky dokument u miratua nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen e mbajtur me
XXXXXX.



Të dashur qytetarë të Komunës së Gjakovës,

Ju njoftoj se Komuna e Gjakovës ka hartuar Planin Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në periudhën 2024-2026.

Ky plan është një shprehje e vullnetit dhe përgjegjësisë tonë ndaj të gjithë komuniteteve tona, duke pasur si qëllim të qartë përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe përfshirjen e tyre aktive në zhvillimin e komunës sonë.

Komuna e Gjakovës ka një detyrim moral dhe ligjor për të garantuar zbatimin e këtij plani në mënyrë të plotë, ashtu siç kemi punuar për zbatimin e planit të kaluar. Ky proces do të jetë

transparent duke inkurajuar sa me shumë kontributin e të gjithë palëve të interesuara.

Diversiteti etnik është pasuri e komunës tonë, dhe komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian janë pjesë integrale e trashëgimisë sonë të përbashkët. Prandaj, do të punojmë me vendosmëri për të përmirësuar kushtet në dimensione kyçe siç janë: arsimi, punësimi mirëqenia sociale dhe shëndetësia.

Në fushën e arsimit, do të kujdesemi që shkollat tona të jenë mjedise të përgjegjshme dhe të inkurajojnë zhvillimin e të gjithë nxënësve. Për punësim dhe mirëqenie sociale, përmes politikave dhe projekte do të inkurajojmë përfshirjen e komuniteteve në tregun e punës. Gjithashtu, do të angazhohemi në përmirësimin e kushteve të banimit dhe do të ndërmarrim hapa të nevojshëm për të luftuar diskriminimin në të gjitha format e tij.

Në fund, kjo nuk është vetëm një përgjegjësi e institucionit tonë, por një thirrje për bashkëpunim dhe pjesëmarrje për të gjithë qytetarët tanë.

Vetëm duke bashkuar forcat dhe duke punuar së bashku, mund të krijojmë kushte për gjithëpërfshirje dhe mund të kemi komunitete më të qëndrueshme dhe kontributdhënëse në politikën tonë lokale.

Me respekt!

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	5
Përmbledhje ekzekutive	6
1. Hyrje	6
2. Metodologjia.....	7
3. Analiza e gjendjes	9
3.1. Arsimi.....	10
3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale	11
3.3. Shëndetësia	13
3.4. Banimi	13
3.5. Antidiskriminimi.....	14
3.6. Kultura dhe Mediat	14
Çështje të përbashkëta dhe të ndërlidhura.....	15
4. Vizioni, misioni, vlerat dhe parimet	16
5. Objektivat strategjikë.....	16
5.1. Arsimi.....	17
5.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale	21
5.3. Shëndetësia	25
5.4. Banimi	28
5.5. Anti diskriminimi.....	29
5.6. Kultura dhe Mediat	30
6. BUXHETI.....	32
7. Plani i zbatimit	34

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BSFK	Balkan Sunflowers Kosova
DAP	Drejtoria Komunale e Administratës dhe Personelit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DP	Drejtoria Komunale për Bujqësi
DPI	Drejtoria Komunale për Punë Inspektuese
DSHMS	Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
DSHP	Drejtoria Komunale Shërbimeve Publike
DI	Drejtoria Komunale për Infrastrukturë
DUP	Drejtoria Komunale për Urbanizim dhe Planifikim
DZHE	Drejtoria Komunale për Zhvillim Ekonomik
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KEEN	Projekti: Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
KK	Kuvendi Komunal
Komuna	Komuna e Gjakovës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
QM	Qendër Mësimore
QKMF	Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra të Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SHFMU	Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët
SHML	Shkolla e Mesme e Lartë
VoRAE	Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
SISH	Sistemi Informativ Shëndetësorë

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Gjakovës është Komuna në të cilën jetojnë më së shumti banorë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian krahasuar me të gjitha komunat tjera të Kosovës. Situata e përgjithshme e këtyre komuniteteve në këtë Komunë vlerësohet relativisht e mirë krahasuar me gjendjen e tyre në komunat tjera të Kosovës, por pavarësisht kësaj, konsiderohet se ende ka nevojë për përmirësimin e situatës së tyre në shumë fusha e drejtime, andaj kërkohet një fokus më i madh i Komunës së Gjakovës në këtë drejtim.

Në mesin e shumë problemeve me të cilat ballafaqohen komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës, Grupi Punues për hartimin e “Planit Lokal të Veprimit për Avancimin e Drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës 2024 -2026 dhe duku u bazuar edhe në “Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali i Republikës së Kosovës 2022-2026” dhe “Plani Veprimit 2022-2024” ka vendosur që në kuadër të këtij plani lokal të veprimit të përfshihen katër fushat në vijim:

- Arsimi
- Punësimi dhe mirëqenia sociale
- Shëndetësia
- Banimi
- Antidiskriminimi
- Kultura dhe Mediat

1. Hyrje

Komuna e Gjakovës është njëra ndër shtatë komunat më të mëdha në Kosovë, përkatësisht njëra ndër qendrat regjionale të Kosovës. Komuna e Gjakovës është e përbërë prej 90 vendbanimeve dhe ka një popullsi rezidente prej 94,556 banorëve¹, nga të cilët 40,827 banojnë në zonën urbane dhe 53,729 në atë rurale. Grupet etnike janë: Shqiptar (87,672), Egjiptian (5,117), Rom (738), Ashkali (613), Boshnjak (73), Serb (17), Turq (16), Goran (13) dhe të tjerë ².

Në aspektin organizativ, Komuna e Gjakovës përbëhet nga 13 Drejtori Komunale:

- Drejtorja e Arsimit
- Drejtorja e Administratës dhe Personelit
- Drejtorja për Punë Inspektuese
- Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtorja për Financa
- Drejtorja për Urbanizim dhe Planifikim
- Drejtorja e Shërbimeve Publike

¹ Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2011.

² <http://banimidhehapesira.com/?l=61&id=36>

- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
- Drejtoria e Gjeodezisë
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
- Drejtoria e Infrastrukturës
- Drejtoria për Bujqësi.

Në Komunën e Gjakovës jetojnë një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë më 2011, në Komunën e Gjakovës jetojnë gjithsej 6,468 pjesëtarë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Pjesa më e madhe e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës jetojnë në pjesën urbane të qytetit të Gjakovës, të koncentruar kryesisht në pesë lagje: Brekoc, Koloni, Dardani, Qyl, Sefë ,ndërsa pjesa tjetër e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian jetojnë në zonat rurale të Komunës së Gjakovës, të koncentruar kryesisht në fshatrat: Rogovë, Skivjan, Planqor, Osekhilë.

Pavarësisht se në përgjithësi vlerësohet se në Komunën e Gjakovës komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë mirë të integruar dhe jetojnë në kushte të mira krahasuar me komunat tjera, sërish konsiderohet se gjendja e këtyre komuniteteve në këtë Komunë duhet përmirësuar.

Bazuar në këtë, Komuna e Gjakovës së bashku me Komisioni Komunal Veprues është angazhuar që ta punojë “Planin e Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Gjakovës 2024-2026” së bashku me bashkëpunëtorë edhe OJQ- të që veprojnë në Komunën e Gjakovës

2. Metodologjia

Procesi i hartimit të “Planit Lokal të Veprimit për Avancimin e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë për Komunën Gjakovës 2024-2026” ka qenë një proces i cili ka kaluar në disa faza , duke përfshirë formulimin e grupit punës të Komunës Gjakovës, takime të ndryshme ,bashkëpunim me akterë të tjerë dhe në përmbajtjen e saj ka të përfshira sugjerimet, kërkesat dhe kontributet të ndryshme nga përfaqësues të ndryshëm të Komunës së Gjakovës si vetë zyrtarët e drejtorive të ndryshme si pjese kyqe të këtij plani, përfaqësues të OJQ-ve , zyrtarë të Zyrës Komunal për Komitete dhe Kthim.

Në anën tjetër, gjithë procesi është organizuar nga projekti i financuar nga Komuna e Gjakovës, përkatësisht buxheti i Zyrës Komunal për Komunitete dhe Kthim.

Në përputhje me detyrimet që ka marrë përsipër Komuna e Gjakovës, kryetari Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini, me 1 Mars 2023 ka marrë vendim për themelimin e Komitete Komunal Koordinues për zbatimin e ‘’Strategjisë dhe Planit të Veprimit’’ për përfshirjen e komuniteteve Rom ,Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë kosovare 2024-2026 me këtë përbërje:

1. Eranda Kumnova Baqi – Drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit
2. Adelina Shehu Kola- Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
3. Arben Bakalli- Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Hapësinor dhe Urbanizëm
4. Armend Behluli – Udhëheqës i Sektorit të Komunitete

5. Lumnije Shllaku- Udhëheqëse e Sektorit për Barazi Gjinore
6. Gani Rama – Zyrtari Kryesor Financiar
7. Lendrit Qeli – Drejtor Ekzekutiv i OJQ Prosperiteti
8. Emrah Cermjani – Drejtor Ekzekutiv i OJQ Roma in Action.

Procesi i hartimit të “Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës 2024-2026” deri te miratimi i këtij dokumenti nga Kuvendi Komunal i Komunës së Gjakovës ka kaluar nëpër disa faza, nëpër të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme. Fazat në fjalë janë të përshkruara shkurtimisht në vijim:

Faza 1: Përgatitja

Faza 2: Përcaktimi i fushave

Fushat janë të caktuara nga ”Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali 2022-2026”, mirëpo në Komunën e Gjakovës e shohim të nevojshme të përcaktohet edhe një fushë tjetër e cila është Media dhe Kultura.

Faza 3: Analiza e gjendjes dhe mbledhja e të dhënave

Faza 4: Përcaktimi i objektivave dhe aktiviteteve të planit të veprimit

Faza 5: Planifikimi i buxhetit dhe planit të zbatimit

Faza 6: Hartimi i dokumentit të planit të veprimit

Strategjia është e bazuar në tri parime kryesore dhe është harmonizuar me Kornizën e BE-së për Integrimin e Romëve:

- ♣ Parimi i të drejtave të barabarta dhe mundësive të barabarta: Ky parim njeh nevojën që pjesëtarët nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të kenë mundësi të barabarta në të gjitha fushat e shoqërisë, siç është rasti me popullatën shumicë.
- ♣ Parimi i mos diskriminimit: Bazuar në këtë parim të gjitha masat e ndërmarra sigurojnë që, në mënyrë të konsiderueshme, të zvogëlon shkallën e diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në të gjitha aspektet e jetës shoqërore.
- ♣ Parimi i eliminimit të dallimeve: - Një nga arsyet kryesore të përjashtimit social të Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianve është fakti që ata në shumicën e rasteve jetojnë në vendbanime të ndara dhe të izoluar nga të tjerët. Kështu mekanizmat dhe faktorët socialë riprodhojnë marginalizimin dhe pengojnë masat e veprimit që synojnë përfshirjen sociale.

Objektivat strategjike të Strategjisë janë të ndërlidhura edhe me planin lokal të veprimit të Komunës janë të caktuar pesë objektiva strategjike si në vijim:

Objektiva strategjike 1: Rritja efektive e ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ;

Objektiva strategjike 2: Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian;

Objektiva Strategjike 3: Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore;

Objektiva Strategjike 4: Rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike, për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian;

Objektiva Strategjike 5: Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjyqimeve, stereotipeve dhe bullizmit;

Objektiva Strategjike 6: Informimi dhe promovimi i aktiviteteve kulturore-sportive të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, promovimi i ditëve nacionale të komuniteteve.

3. Analiza e gjendjes

Grupi Punues për hartimin e “Planit Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës 2024-2026”, pas diskutimeve që ka pasur, ka vendosur që në kuadër të këtij plani të veprimit të përfshihen gjashtë fusha kryesore, të cilat janë edhe pjesë e strategjisë shtetërore në nivel të Kosovës “Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2024-2026”.

Kështu është vendosur që në kuadër të “Planit Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës 2024-2026” të përfshihen katër fushat në vijim:

- Arsimi
- Punësimi dhe mirëqenia sociale
- Shëndetësia
- Banimi
- Antidiskriminimi
- Media dhe Kultura

3.1. Arsimi

Sikur edhe në gjithë Kosovën, edhe në Komunën e Gjakovës përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit para universitar vazhdon të mbetet në nivel jo të kënaqshëm.

Ne Komunën e Gjakovës në shkollat fillore janë 10.050 nxënës gjithsejtë nga ta 1.259 janë nga komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ndërsa në shkollat të mesme janë gjithsejtë 3.209 nxënës dhe nga ta 113 janë nga komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Në Komunën e Gjakovës janë 41 Shkollat Fillore të Mesme të Ulta, dhe 6 Shkollat të Mesme të Larta.

Në çerdhen publike “Ganimete Tërbeshi” në nivel 3-4 vjeçar janë 2 fëmijë nga komuniteti Ashkali, 2 nga komuniteti Rom dhe 21 nga komuniteti Egjiptian, ndërsa nga mosha 4-5 vjet vetëm një fëmijë nga komuniteti Rom nga gjithsejtë 533 fëmijë. Ndërsa në parashkollor në shkollat e Komunës së Gjakovës janë 27 nxënës nga komuniteti Ashkali, 15 nga komuniteti Rom dhe 22 nga komuniteti Egjiptian nga gjithsejtë 789 nxënës në 37 Shkollat Fillore për vitin shkollor 2023-2024. Numri i nxënësve të komuniteteve në shkollat fillore është si në vijime klasë të parë janë 175 nxënës nga komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në klasë të dytë janë 157 nxënës në klasë të tretë 124, në klasë të katërtë 112, në klasë të pestë 149, në klasë të gjashtë 162, në klasë të shtatë 149 në klasë të tetë 135, dhe në klasë të nëntë 96 nxënës nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në gjithë Komunën e Gjakovës, për më tepër referoheni tek tabela 1.

Ndërsa në Shkollat të Mesme të Komunës së Gjakovës gjithsejtë janë 3.209 nga ta 113 janë nga komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në klase të dhjetë janë 40, në klasë të njëmbëdhjetë 28, në klase të dymbëdhjetë 45 nxënës, për më tepër referohuni tabelën nr.2.

Tabela 1. Nxënësit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian nga kalsa 1 deri 9 në shkollat e komunës së Gjakovës

Klasa	Ashkali	Rome	Egjiptian	Gjithsejtë
Klasa 1	76	42	57	175
Klasa 2	95	12	50	157
Klasa 3	59	21	52	124
Klasa 4	47	21	44	112
Klasa 5	86	19	44	149
Klasa 6	100	10	52	162
Klasa 7	83	17	49	149
Klasa 8	62	16	57	135
Klasa 9	40	12	44	96
Gjithsejtë	648	170	449	1259

Tabela nr.2.Nxënësit e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptian ne shkollat e mesme te komunës se Gjakovës

Klasa	Ashkali	Rome	Egjiptian	Gjithsejtë
Klasa 10	2	1	37	40
Klasa 11	0	1	27	28
Klasa 12	6	2	37	45
Gjithsejtë	8	4	101	113

3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Papunësia vazhdon te jetë problem në tërë Kosovën, pavarësisht përkatësisë etnike dhe as Komuna e Gjakovës nuk ka përjashtim në këtë aspekt. Por, niveli i papunësisë në mesin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian llogaritet të jetë jashtëzakonisht shumë i lartë krahasuar me nivelin e papunësisë në nivel të përgjithshëm të popullatës në Kosovë.

Sipas Zyrën së Punësimit në Gjakovë gjate viti 2023 janë të regjistruar gjithsejtë punëkërkues aktive 6075 persona, 458 prej tyre janë nga komunitete rome, ashkali dhe egjiptian. Përfitues të projekteve të punësimit nga komunitete rome, ashkali dhe egjiptian janë 22 persona apo 8% te totalit. Gjatë vitit 2023 ZP në Gjakove ka lëshuar 751 deklarata të papunësisë, të cilët të gjithë nuk jam përfitues të ndihma sociale. Po ashtu të punësuar nga zyra e punësim gjatë vitit 2023 janë 121 persona, nuk ka të dhëna të sakta për numrin e të punësuarve në sektorin publik në nivel komunal, në sektorin publik në nivel qendror dhe në sektorin privat.

Përveç shkaktarëve të përgjithshëm që ndikojnë në nivelin e lartë të papunësisë, ka edhe shkaktarë të veçantë që i kontribuojnë papunësisë së madhe të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës të fundit ka mjaft kuadro të kualifikuar nga radhët e këtyre komuniteteve ,ndër shkaktarët është mungesa e kuadrove të caktuar me kualifikime universitare nga radhët e këtyre komuniteteve, gjë që e vështirëson punësimin e tyre në mungesë të plotësimit të kriterëve ligjore, posaçërisht në sektorin publik, sidomos deri në arritjen e plotësimit të kuotave për punësimin e komuniteteve që parashihen me ligj e cili problem vazhdon te mbete e pa plotësuar, vlerësohet që nuk është bërë mjaftueshëm nga Komuna për punësimin e atyre kuadrove nga këto komunitete që kanë kualifikime universitare, edhe pse gjate viteve te fundit numri i te kualifikuarve është rritur mjaftueshëm vazhdon të ketë punësim të ulët në Komunën e Gjakovës, e për këtë duhet më shumë vullnet nga Komuna për t’ju ofruar mundësi këtyre kuadrove për punësim në institucionet publike komunale.

Komuna e Gjakovës ka adresuar problemin e papunësisë në mesin e këtyre komuniteteve dhe në kuadër të përpjekjeve dhe angazhimeve të saj ka mundësuar qe te rinjtë e komuniteteve të ndjekin trajnime te ndryshëm në Qendrën e Aftësimit Profesional (QAP) ku vetëm gjate vitit 2023 kanë përfunduar trajnimet dhe janë certifikuar një kuzhinier dhe 8 rrobaqepës , ka ofruar subvencione për fushën e zejtarisë dhe bujqësisë (pajisje dhe trajnime profesionale), nga të cilat kanë përfutuar edhe pjesëtarët e këtyre komuniteteve (të vetë-punësuar në këto fusha), ka përkrahur punësimin

sezonal të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në ndërmarrjet publike komunale, si dhe ka përkrahur në forma të ndryshme OJQ-të që merren me adresimin e papunësisë së këtyre komuniteteve në Komunën e Gjakovës.

Niveli i lartë i papunësisë të pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës, përveç faktorëve të tjerë, është faktori kyç që ndikon në gjendjen e rëndë të mirëqenies sociale të këtyre komuniteteve në këtë Komunë. Numri familjeve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në këtë Komunë që marrin asistencë sociale janë: 439 me gjithsejtë 2.046 anëtarë. Janë shfaqur shqetësime edhe sa i përket mënyrës së funksionimit të skemës sociale, për shkak se gjatë punësimit sezonal këtyre familjeve ju ndërpritet skema sociale, prandaj, meqë punësimi sezonal është i përkohshëm, shumë nga ta hezitojnë për punësime të tilla, sepse pas punësimit sezonal ballafaqohen me mjaft probleme për t'u rikthyer në skemë sociale përsëri.

N'funksion të përmirësimit të mirëqenies sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës vlerësohet se Komuna në bashkëpunim dhe me përkrahjen edhe të akterëve të tjerë duhet të ndërmarrin fushata informuese për skemat e ndihmës sociale dhe për skemat e mbrojtjes dhe shërbimeve sociale që ofrohen nga niveli komunal. Gjithashtu, Komuna në bashkëpunim me donatorët duhet të ofrojnë pako ushqimore dhe veshmbathje për familjet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian me gjendje shumë të rëndë ekonomike në këtë komunë.

Në bazë të dhënave zyrtare të dërguara nga Ministria për Punë dhe Mirëqenies Sociale në skemat sociale janë 1.049 familje me 4.191 anëtarë, nga ta 439 familje janë nga komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian me gjithsejtë 2.046 anëtarë të familjes.

Ndërsa sa i përket banimit social të dhënat nga Drejtoria Shëndetësisë dhe Mirëqenës Social janë 48 njësi banimi e cila gjendet ne rrugën Tirana dhe vetëm një nga këto njësi shfrytëzohet nga komuniteti egjiptian.

Tabela.3.Struktura e familjeve dhe anëtareve të familjes në SNS

Komuniteti	Numri Familjeve	Numri anëtareve të familjes
Ashkali	197	885
Egjiptian	110	555
Rome	132	606
Totali	439	2046

3.3. Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore në Komunën e Gjakovës kanë një shtrirje të gjerë dhe mbulojnë gjithë territorin e Komunës. Rrjeti i Institucioneve të KPSH-se (kujdesi parësor shëndetësor) në Komunën e Gjakovës përfshinë qytetin, dhe katër regjione gjeografike të pjesët rurale të Komunës.

Kjo Komunë përveç Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) disponon edhe me 9 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe me 15 ambulanca shëndetësore. Të gjitha këto bëjnë që sa i përket qasjes së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shërbimet shëndetësore në komune e Gjakovës të mos ketë shumë probleme, megjithëse ka edhe shqetësime sa i përket fushës së shëndetësisë për këto komunitete. Kujdesi parësorë shëndetësor në Komunën e Gjakovës ofron shërbime shëndetësore të cilat zbatohen nga QKMF-ja.

Janë disa suksese të Komunës së Gjakovës që mund të përmenden kur flasim për fushën e shëndetësisë që lidhen me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të kësaj Komune. Vetë prezenca e shërbimeve shëndetësore afër të gjitha vendbanimeve është shumë me rëndësi për këto komunitete, në mënyrë që ta kenë më të lehtë dhe pa kosto të udhëtimit qasjen në këto shërbime. Komuna e Gjakovës, në bashkëpunim me donatorët dhe me OJQ-të e ndryshme, përveç fushatave vetëdijesuese për rëndësinë e shëndetit të këto komuniteteve, ka organizuar edhe vizita në shkolla, në QM dhe në familje për të realizuar vaksinimin e fëmijëve të pavaksinuar të këtyre komuniteteve. Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit gjatë vitit 2023 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë: Mosha 0-11 muaj-142 fëmijë të vaksinuar, 12-24 muaj 29 fëmijë të vaksinuar, 6-7 vjeç 67 fëmijë të vaksinuar, ndërsa neper shkollat e Komunës së Gjakovës janë vaksinuar :mosha 12-13 vjeç 52 fëmijë, 18 vjeç 6 fëmijë.

Po ashtu DSHMS çdo vit jepë subvencione për personat e sëmurë të Komunës së Gjakovës ku në listat e përfituesve çdo herë janë të përfshirë.

3.4. Banimi

Sikur edhe në fushat tjera të sipër-përshkruara, edhe sa i përket banimit, del se komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Gjakovës kanë mjaft probleme dhe vështirësi, sepse shumë familje kanë probleme me kushte të vështira banimi, me mungesë të pronave private për ndërtim, me probleme të pronësisë, me banime në vendbanime joformale, me vendbanime pa mirëmbajtje të duhur, si dhe me mungesë strehimi.

Komuna e Gjakovës deri më tani ka punuar mjaft shumë për sigurimin e banimit dhe strehimit për familjet në nevojë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të kësaj Komune. Në aspektin e banimit social, përmes partneritetit mes Komunës së Gjakovës, Caritas-it Zviceran dhe

Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim, tashmë Komuna e Gjakovës ka kapacitet prej 44 banesave, të ndara në dy blloqe banimi, si dhe 130 shtëpive individuale të cilat gjenden në lagjen Ali Ibra. Ky projekt është realizuar në vitin 2013 dhe nga ky projekt kanë përfituar disa familje të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që janë pjesë e skemës sociale. Po në 4 vitet e fundit me ndihën e shumë donatorëve dhe Ministrive janë ndërtuar edhe 58 shtëpi të tjera për komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës të cilat kanë zbutur sa do pak problemet e banimit dhe të strehimit të këtyre komuniteteve.

3.5.Antidiskriminimi

Diskriminimi ekziston në forma të ndryshëm dhe e përfshinë të gjithë popullatën, sidomos në aspektin gjinorë, po ashtu edhe komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian dhe në situatë shoqërore ndihen të diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre etnike është më shumë prezent, sesa tek pjesa tjetër e popullsisë, prandaj ky fenomen kërkon trajtim më afatgjatë. Korniza e BE-së për Integrimin e Romëve, në të cilën bazohet Strategjia për Avancimin e komuniteteve romë dhe ashkali 2022-2026 kufizon luftimin e diskriminimit si: luftimin e diskriminimit, ngacmimit, krimin të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes kundër romëve (ashkalive dhe egjiptianve); promovimin (ndërgjegjësimin) e historisë, kulturës, njohjes dhe pajtimit të romëve(ashkalive dhe egjiptianve).

Diskriminimi, është një fenomen që është prezent në fushën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, banimit, kulturës mediave dhe sportit ku do të trajtohet në këto katër fushat, duke vendosur objektiva specifike të veçanta që i dedikohen diskriminimit. Për secilën nga gjashtë fushat e Planit është definuar një objektiv strategjik. Secili objektiv strategjik është zbërthyer në objektiva specifike, ndërsa këto objektiva specifike më tutje në Planin e Veprimit janë zbërthyer në rezultate dhe në aktivitete.

3.6. Kultura dhe Mediat

Si të gjitha komunitete edhe komunitete romë ashkali dhe egjiptian kanë historinë kulturën e tyre për të cilën munde të promovojnë dhe të avancojnë promovimin e tyre. Komuna e Gjakovës njihet si vend që prodhon e promovon kulturën dhe sportin , dhe po ashtu edhe komunitete që jetojnë në komune Gjakovës kanë mundësi të promovojnë kulturën e tyre me aktivitete të ndryshme kulturore artistike dhe sportive, në komunën e Gjakovës ka organizata të cilat qëllim të tyre kanë promovimin kulturës gjuhës dhe historisë së komuniteteve, po ashtu ka klube sportive ku të rinjtë e komuniteteve shprehin talentet e tyre sportive. Po ashtu komuniteti romë dhe egjiptian kanë hapësirat e tyre në mediat lokale.

Këto organizata e kanë përkrahje nga institucionet lokale dhe subvencionohen nga komuna e Gjakovës dhe ju jepen hapësira publike për të promovuar kulturën historinë e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian.

Pa varësisht të gjithë përkrahjes që kanë këto komunitete në komunën e Gjakovës kërkohet ende që të punohet në këtë fushë dhe në avancimi të këtyre komuniteteve, pasi ka mjaftë për të dhënë, ka kuadro dhe hapësirë të promovohet kultura mediat dhe sporti në e kemi kërkuar që kjo të jete fusha e gjatë e këtij Plan Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të komuniteteve romë ashkali dhe egjiptian 2024-2026.

Çështje të përbashkëta dhe të ndërlidhura

Gjatë analizës së gjendjes së katër (Pesë) fushave të para-përshkruara ka rezultuar se janë edhe dy aspekte të rëndësishme që janë të ndërlidhura me secilën nga ato katër fusha dhe të cilat duhet të adresohen me këtë Plan Lokal Veprimi që lidhet me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës.

Mungesa e të dhënave dhe statistikave për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës, për të gjitha fushat dhe aspektet e rëndësishme të këtyre komuniteteve, është një problem i madh që vështirëson identifikimin e problemeve dhe përmasave të tyre, vështirëson planifikimin e mirëfilltë të ndërmarrjes së masave, si dhe vështirëson zbatimin e këtyre masave. Mungesa e të dhënave, statistika dhe evidencave të nevojshme për këto komunitete nuk është për fajin e Komunës së Gjakovës, sepse nuk është specifike vetëm për këtë Komunë, por lidhet me specifikat e veçanta të këtyre komuniteteve.

Prandaj, është e domosdoshme që Komuna e Gjakovës, në bashkëpunim dhe me përkrahjen e donatorëve dhe akterëve të tjerë, të ndërmerr masa dhe veprime për të siguruar të dhëna, statistika dhe evidenca të nevojshme për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të kësaj komune që lidhen me fushën e arsimit, të punësimit, të mirëqenies sociale, të shëndetësisë, të banimit, kultura dhe mediat etj.

Niveli jo shumë i kënaqshëm i vetëdijesimit të komunitete Rom, Ashkali dhe Egjiptian për aspekte të rëndësishme që ndikojnë në jetën dhe perspektivën e tyre, vlerësohet të jetë problem për këto komunitete në Komunën e Gjakovës, i cili është njëri ndër shkaktarët e problemeve të shumta të këtyre komuniteteve në të gjitha fushat e përfshira në këtë plan veprimi, në arsim, punësim e mirëqenie sociale, shëndetësi, banim, kultura dhe mediat.

Pavarësisht se është bërë shumë në këtë drejtim nga Komuna, institucionet qendrore, donatorët, OJQ-të, mediat, grupet avokuese dhe përfaqësuesit e komuniteteve, sërish vlerësohet se është i nevojshëm organizimi i fushatave gjithëpërfshirëse vetëdiesuese për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës, në mënyrë që pjesëtarët e këtyre komuniteteve t'i kushtojnë më shumë rëndësi dhe vëmendje arsimimit të fëmijëve të tyre, aftësimit profesional që rritë punësimin dhe mirëqenien e tyre, shëndetit personal dhe publik, banimit, etj.

4. Vizioni, misioni, vlerat dhe parimet

Komuna e Gjakovës është komuna në të cilën jetojnë më së shumti pjesëtarë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, krahasuar me të gjitha komunat tjera të Kosovës. Falë vullnetit të mirë dhe punës të institucioneve lokale, atyre qendrore, donatorëve, komunitetit shumicë në këtë Komunë dhe angazhimit e punës së përfaqësuesve të këtyre komuniteteve (të organizuar në QM, OJQ, grupe avokuese, etj.), gjendja e përgjithshme e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës është përmirësuar gradualisht ndër vite dhe është arritur një nivel i mirë i përfshirjes së këtyre komuniteteve në jetën shoqërore e institucionale në nivel komune. Pavarësisht këtyre sukseseve e arritjeve, ende mbetet shumë për të bërë derisa të arrihet përfshirje e plotë e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës, për shkak të problemeve të mëdha e të shumta me të cilat ballafaqohen këto komunitete, adresimi dhe zgjidhja e të cilave kërkon shumë kohë dhe mjete financiare.

Pikërisht në funksion të përmirësimit të mëtutjeshëm të gjendjes dhe integritetit të plotë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në këtë Komunë

Komuna e Gjakovës ka marrë përsipër hartimin dhe zbatimin e këtij “Plani Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës 2018-2022”, që është një dëshmi e vazhdimit të përkushtimit të kësaj Komune për të punuar edhe në të ardhmen për integrimin e plotë të këtyre komuniteteve.

Bazuar në të gjitha ato që u sipër-përmenden, kjo Komunë ka përcaktuar vizionin e saj që **“Komuna e Gjakovës do të jetë një vend ku të gjitha komunitetet do të jenë të barabartë në të gjitha fushat jetësore dhe do të jetojnë me respekt të ndërsjellët e në harmoni të plotë me njëri tjetrit”**.

Në funksion të arritjes së këtij vizioni, kjo Komunë ka përcaktuar edhe misionin e saj që **“Komuna e Gjakovës do të vazhdojë të mbetet e përkushtuar që të rrisë përfshirjen dhe të ofrojë arsim cilësor për fëmijët dhe nxënësit e këtyre komuniteteve; të ndihmojë në rritjen e nivelit të punësimit dhe në përmirësimin e mirëqenies sociale për këto komunitete; të ofrojë shërbime shëndetësore sa më cilësore për këto komunitete; dhe të zbusë problemin e mungesës së strehimit dhe banimit të qëndrueshëm për këto komunitete”** dhe të promovojë sa me shumë kulturën e këtyre komuniteteve dhe të jap sa me shumë qasje në media..

E gjithë kjo ndërmarrje bazohet në vlerat themelore humane, si: ***gjithëpërfshirja, drejtësia dhe respekti***, si dhe në parimet universale të të drejtave të njeriut, si: të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë dhe mosdiskriminim për askënd.

5. Objektivat strategjike

Bazuar në analizën e gjendjes që është prezantuar në fillim të këtij dokumenti dhe fushat që janë përfshirë në këtë analizë, ky “Plan Lokal i Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës 2024-2026” ka përcaktuar gjashtë objektiva strategjike, nga një objektiv për secilën nga fushat e përfshira në analizën e gjendjes, të cilat pastaj janë zbërthyer në rezultate të pritshme, ndërsa rezultatet e pritshme janë

zërthyer në aktivitete specifike, të cilat janë përshkruar hollësisht. Të gjitha këto janë të prezantuara dhe të përshkruara në vijim të këtij dokumenti

5.1. Arsimi

Arsimimi është qelësi kryesore për zhvillimin, emancipimin dhe mirëqenien e secilit individ e sidomos për avancimin e komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptian. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e madhe të arsimit, është vendosur që fusha e parë e si me e rëndësishmja e këtij “Plani Lokal të Veprimit për Avancimin të drejtave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës 2024-2026” të jetë arsimi, sepse arsimi konsiderohet pikënisje e zgjidhjes së shumë problemeve dhe e përmirësimit të situatës së përgjithshme të këtyre komuniteteve.

Sfidat kryesore

Komunitete Rome, Ashkali dhe Egjiptian në komunën e Gjakovës edhe përkundër faktit që është punuar ndër vite në fushën e arsimit ende ballafaqohen edhe me sfida të ndryshme nga të cilat disa prej tyre janë:

- Përfshirja jo e mjaftueshme e nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në arsimin parauniversitar në Komunën e Gjakovës, posaçërisht në edukimin parashkollor dhe në shkollimin e mesëm të lartë.
- Mos regjistrimi me kohe në parashkollorë dhe klasë të parë, dhe mbetja mbrapa me mësimet krahasuar me shumicën e cila ndikon edhe në suksesin e jo të mirë të nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian krahasuar me mesataren e suksesit të nxënësve të tjerë.
- Braktisja e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në arsimin para universitar në Komunën e Gjakovës, posaçërisht në nivelin e shkollimit të detyruar, në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1 – 9).
- Vetëdijesimi i ulët i prindërve të komuniteteve për rëndësinë e shkollimit

Objektivi 1 : Rritja efektive e ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Lokal Veprimi për fushën e arsimit parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- Rezultati 1: Vetëdijesimi dhe promovimi i rëndësisë së arsimimit dhe përfshirjes të fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në të gjitha nivelet e arsimit dhe tek të gjithë akterët relevantë
- Rezultati 2. Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

- Rezultati 3. Përmirësimi i performancës akademike të nxënësve dhe studentëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes programeve të specializuara plotësuese dhe masave afirmative në arsim
- Rezultati 4. Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Rezultati 1.1: Vetëdijësimi dhe promovimi i rëndësishëm të arsimit dhe përfshirjes të fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në të gjitha nivelet e arsimit dhe tek të gjithë akterët relevantë

Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
Aktiviteti 1.1.1: Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin para fillor	Përshkrimi i aktivitetit 1.1.1: ZKKK dhe DKA e Komunës së Gjakovës, në bashkëpunim me IP-të dhe shkollat, si dhe me përkrahjen e Grupit Këshillues në Komunitete të QM-ve, të grupeve avokuese dhe të donatorëve të ndryshëm organizojnë fushata informuese për familjet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian para dhe gjatë afateve të regjistrimit të fëmijëve dhe nxënësve në institucioneve edukativo-arsimore (Para fillorë, IP), në mënyrë që askush të mos mbetet pa u regjistruar për shkak të mungesës së informatave. Përveç informimit, akterët e mësipërm mund t'i ndihmojnë prindërit edhe rreth procedurave dhe dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve/nxënësve. Këto fushata informuese dhe ndihmesa për regjistrim bëhen në baza vjetore (në afatet e regjistrimit) dhe mund të realizohen përmes formave dhe mjeteve të ndryshme, si: shpërndarja e fletëpalosjeve informuese nëpër shtëpi të komuniteteve, nëpër QM, IP dhe shkolla, organizim i takimeve informuese dhe ndihmuese me prindër nëpër QM, IP dhe shkolla, etj.
Aktiviteti 1.1.2: Subvencionimi i pagesave të çerdhes për rritjen e përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian	Përshkrimi i aktivitetit 1.1.2: Komuna e Gjakovës stimulon regjistrimin e fëmijëve të komuniteteve në IP-në publike, duke caktuar një kuotë (psh. 5% të numrit të përgjithshëm të fëmijëve) për ta dhe duke marrë përsipër mbulimin e pjesshëm apo të tërësishëm të shumës së participimit për këta fëmijë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Gjithashtu, QM-të me bazë në komunitet, me përkrahje nga donatorët, mund të rrisin kapacitetet e tyre dhe duke ofruar ambient atraktiv dhe ushqim për fëmijët vijues ndikojnë që të rritet numri i fëmijëve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që vijnë në edukimin parashkollor në QM.

Aktiviteti 1.1.3: Subvencionimi I Qendrave Mësimore Qendra me baze në komunitet dhe me baze në shkollë për zhvillimin e aktiviteteve	Përshkrimi i aktivitetit 1.1.3: Në komunën Gjakovës janë dy Qendra Mësimore me baze në komunitete dhe qendra të tjera me baze në shkollë, përveç subvencionimit të QM nga MASHT të gjenden mundësi të subvencionohet nga Komuna(shpenzime Komunale) dhe donatorët të tjerë për aktivitete dhe funksionalizim sa më të mirë.
Rezultati 2. Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian	
Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
Aktiviteti 2.1.1 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë	Përshkrimi i aktivitetit 2.1.1: ZKKK dhe DKA e Komunës së Gjakovës, në bashkëpunim me shkollat, si dhe me përkrahjen e Grupit Këshillues në Komunitet të QM-ve, të grupeve avokuese dhe të donatorëve të ndryshëm organizojnë fushata informuese për familjet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian para dhe gjatë afateve të regjistrimit të fëmijëve dhe nxënësve në institucioneve edukativo-arsimore në mënyrë që askush të mos mbetet pa u regjistruar për shkak të mungesës së informatave. Përveç informimit, akterët e mësipërm mund t'i ndihmojnë prindërit edhe rreth procedurave dhe dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve/nxënësve.
Aktiviteti 2.1.2: Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe sigurimi i mjeteve arsimore	Përshkrimi i aktivitetit 2.1.2: bashkëpunim me QM dhe shkollat krijohen lista edhe gjenden donatore të ndryshëm për sigurimin e mjeteve didaktike shkollore
Aktiviteti 2.1.3 : Adresohen rastet e braktisjes dhe fëmijëve	Përshkrimi i aktivitetit 2.1.3: DKA e Komunës së Gjakovës rritë bashkëpunimin me shkollat dhe kërkon nga ato që në baza të rregullta të raportojnë në DKA për rastet kur nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian e braktisin shkollimin. Bazuar në këto raportime EPBRM shkollore i adreson rastet që nuk mund të kthejë në shkollë, EMBRM komunale në bashkëpunim me EPBRM shkollore vizitojnë familjet dhe riktheje nxënësit në shkollë ,duku e bazuar edhe në PLV për EPBRM-të
Aktiviteti 2.1.4. Fuqizimi dhe aktivizim i GKK-se (Grupi Këshillues në Komunitet)	Përshkrimi i aktivitetit 2.1.4: Në vazhdimësi të aktiviteteve, fushatave për regjistrimin e nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në para fillor ,fillore dhe të mesëm të koordinohen dhe ta krijojmë planin veprimi dhe mos duplikohen aktivitete pasi GKKK është grup kompakt ku përfshin të gjithë akterët që janë në mbrojtje të fëmijëve.

Rezultati 3. Përmirësimi i performancës akademike të nxënësve dhe studentëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes programeve të specializuara plotësuese dhe masave afirmative në arsim	
Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
Aktiviteti 3.1.1: Organizohen kurse dhe mbështetje për nxënës dhe studentët për lëndet që kanë ngece	Përshkrimi i aktivitetit 3.1.1: DKA e Komunës së Gjakovës në bashkëpunim me shkollat dhe me organizata të ndryshme që ndihmojnë në arsimim e nxënësve komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian sigurohet që të ofrojnë mësim plotësues (jashtë orarit) për nxënësit e këtyre komuniteteve që kanë sukses jo të mirë, në mënyrë që ata të përkrahen që t'i zotërojnë sa më mirë përmbajtjet mësimore që kërkohen nga shkolla dhe lëndët përkatëse.
Aktiviteti 3.1.2 Përkrahja me bursa për nxënësit e shkollave të mesme	Përshkrimi i aktivitetit 3.1.2: Ministria Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ndanë bursa për nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që vijnë në shkollimin e mesëm të lartë, bazuar në suksesin e tyre gjatë shkollimit dhe bazuar në kushtet e tyre ekonomike, duke ju dhënë përparësi (përmes kuotave) nxënësve të gjinisë femërore. Në rastet të caktuara ka edhe organizata që ndihmojnë me bursa nxënësit e këtyre komuniteteve. Ndarja e bursave, përveç që i kontribuon rritjes së përfshirjes së nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shkollimin e mesëm të lartë, në të njëjtën kohë i kontribuon edhe rritjes së suksesit të këtyre nxënësve gjatë shkollimit.
Aktiviteti 3.1.3 Përkrahja me bursa për studentet	Përshkrimi i aktivitetit 1.1.3: DKA në bashkëpunim me ZKKK-në në baze të rregullores komunale për subvencione çdo vite ndajnë 5 bursa për studentët komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian me konkurrencë mes vete, ndarja e bursave kontribuon në rritjen e numrit të studenteve dhe suksesit të tyre sa më të mirë gjatë studimeve.
Aktiviteti 3.1.4 Informim dhe promovimi i thirrjeve publike për dhënjën e bursave	Përshkrimi i aktivitetit 3.1.4: Në kohën e hapjes së çdo thirrje publike për ndarjeve të bursa të organizohen fushata të ndryshme informuese të përdorën media televizive dhe mediat social që të promovohen thirrjet publike dhe të ketë sa më shumë aplikues dhe përfitues të bursave.
Rezultati 4. Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	
Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
Aktiviteti 4.1.1 Organizohet arsimimi joformal për fëmijët që	Përshkrimi i aktivitetit 4.1.1: Të organizohet mësimi jo formal/intensiv për nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shkollën e caktuar

kanë vonesa në shkollimin e obliguar	nga DKA, dhe të përpilohen listat nga shkollat dhe bashkëpunëtorë që të jen pjesë e mësimit joformal. Kjo do të kontribuoj që të gjithë ata persona që kanë mbetur pa përfunduar mësimi të kenë mundësi të ndjekin mësimet dhe të përfundojnë mësimin fillore dhe të kenë diplomë.
Aktiviteti 4.1.2 Organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjytimeve për mësimdhënës	Përshkrimi i aktivitetit 4.1.2: DKA ne bashkëpunim me ZKKK dhe bashkëpunëtorët tjerë të organizoj mbajtjen e ligjëratave me tema të caktuar për mësimdhënësit që janë të punësuar gjatë 5 viteve të fundit me faza për të gjithë të cilat ligjëratat do të kontribuojnë në njohjen e komuniteteve dhe zbutjen e paragjytimeve për komunitete të cilat jetojnë në Kosovë.
Aktiviteti 4.1.3: Monitorimi i suksesit dhe qëndrueshmëria e intervenimit	Përshkrimi i aktivitetit 4.1.3: Komuna e Gjakovës e ka të formuar me vendim Komisionin Komunal Veprues e cila ka për detyrë të monitoroj këtë Plan Veprimi dhe ju kërkohet që ky grup të fuqizohet dhe të aktivizohet që të ketë monitorim sa më të mirë dhe implementim sa më të suksesshëm.

5.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Niveli i lartë i papunësisë në mesin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Gjakovës është shkaktar i shumë problemeve socio-ekonomike për këto komunitete. Në njërin anë punësimi është i lidhur dhe i ndikuar drejtpërdrejt nga niveli i shkollimit, ndërsa në anën tjetër është i lidhur dhe ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien sociale të këtyre komuniteteve, rritja e nivelit të punësimit është shumë me rëndësi, prandaj dhe është vendosur si fusha e dytë e këtij “Plani Lokal të Veprimit për Avancimin e të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës 2024-2026” të jetë punësimi, sepse vet nevoja për punësim i nxitë këto komunitete që t’i kushtojnë më shumë rëndësi arsimit dhe në të njëjtën kohë punësimi i kontribuon përmirësimit të mirëqenies sociale të këtyre komuniteteve.

Sfidat kryesore

- Niveli shumë i ulët i punësimit, përkatësisht shkalla shumë e lartë e papunësisë në radhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Gjakovës.
- Mungesa e kuadrove të kualifikuar dhe përfshirja jo e kënaqshme në aftësimin e profesional e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës.

- Pamundësia e ofrimit të shërbimeve të duhura sociale për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës si pasojë e mungesës së buxhetit në nivel komunal.

Objektivi 2 :Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Lokal Veprimi për fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- Rezultati 2.1:Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemimit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Zyrrat Komunale për Punësim dhe Programeve të Aftësimi
- Rezultati 2.2.Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes senzibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, si dhe masave stimuluese për punëdhënës
- Rezultati 3.Përfshirja e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në punësim në institucione publike qendrore dhe lokale, sipas kuotave të përcaktuara me ligj

Rezultati 2.1 :Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemimit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Zyrrat Komunale për Punësim dhe Programeve të Aftësimi	
Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
Aktiviteti 2.2.1: Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian (i të papunëve dhe punëkërkuesve) dhe ofrimi i këshillave për punësim	Përshkrimi i aktivitetit 2.2.1: Zyra Punësimit ka data bazën në të cilën regjistron secilin person që paraqitet aty. Çdo person i cili lajmërohet në ZP regjistrohet, këshillohet në karrierë dhe orientohet për QAP për të përfunduar ndonjë trajnim.
Aktiviteti 2.2.2: Ofrimi i trajnimeve profesionale nga QAP për punëkërkuesit	Përshkrimi i aktivitetit 2.2.2: Komuna e Gjakovës identifikon dhe përkrahë trajnimin e kuadrove nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian Qendrës për Aftësim Profesional (QAP), në mënyrë që ata të pajisen me kualifikime dhe aftësi e kompetenca që përshtaten me nevojat e tregut të punës, për profesionet të cilat nuk gjenden në Komunën Gjakovës orientohen në Pejë dhe në Prizren dhe u mundësohet transporti

Aktiviteti 2.2.3: Këshillimi dhe orientimi ne zgjedhjen e rasteve të dhunës së grave dhe fëmijëve në familje, në strehimoren rehabilituese	Përshkrimi i aktivitetit 2.2.3: Komuna e Gjakovës, përmes DSHMS-së dhe ZKKK-së, si dhe në bashkëpunim dhe me ndihmën OJQ-ve që punojnë me komunitetet, do të organizojë fushata informuese në tërë vendbanimet ku jetojnë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në lidhje me llojet e skemave të ndihmës sociale, mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të tjera sociale që janë në dispozicion, si dhe rreth mundësisë për qasje dhe përfitimin e këtyre skemave. Në komune e Gjakovës ekziston Mekanizmi Kundër Dhunës në Familje në të cilat diskutohen rastet dhe ndihmohen varësish nga nevoja qe ka personi në bashkëpunim me QPS dhe Shtëpinë e Sigurte, ofrimi i pagesave të qirasë dhe orientimi ne institucione të tjera përgjegjëse.
Aktiviteti 2.2.4: Identifikimi i familjeve që janë në asistencë sociale, dhe familjeve të cenueshme, ofrimi i ndihmave me pako ushqimore, higjienike, dru zjarri dhe pako me dhurata	Përshkrimi i aktivitetit 2.2.4: DSHMS dhe QPA posedon listat e familjeve qe janë në asistencë sociale dhe rastet tjera sociale të kategorive të ndryshme, po ashtu edhe ZKKK posedon një liste të personave që paraqiten në zyre dhe kërkojnë ndihma të ndryshme. Përpilimi i listave për nevoja të ndryshme dhe orientimi në organizatat që ofrojnë këto lloj të ndihmave të cilat kohe pas kohe ndihmohen me ndihma të ndryshme varësish prej nevojave të familjeve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
Rezultati 2.3.Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes sensibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, si dhe masave stimuluese për punëdhënës	
Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
